



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 09.10.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03L-040 , nenit 8,9.1,10 dhe 13 shkronja a të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale dhe Përfundimit 6.1 të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të dt: 02.10.2015, me të cilin është miratuar propozimi i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për mbështetje financiare të projektit të festivalit tradicional të këngëve për fëmijë “ Lyra Fest 2015”, me dt: 09.10.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e OJQ “Neo Musica” nr. 10-400-6278 e dt:22.01.2015, për organizimin e festivalit mbarëkombëtarë të këngëve për fëmijë “Lyra Fest 2015”, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në vlerë prej 2,000.00€ .

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 2,000.00€ nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e OJQ “Neo Musica” nr1402000001767857 Banka Ekonomike .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

4. Vendimi iu dorëzohet:

- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Z. Kujtim Nushi, drejtor i festivalit “Lyra Fest” rr. “S. Stavileci” nr.85, Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila